

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtar, në çështjen juridike të paditësit V. H. nga ..., kundër të paditurës Telekom i Kosovës sh.a. me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit dhe kompensimit të diferencës së pagës, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2649/2017 datë 26.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 5.12.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2649/2017 datë 26.3.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2649/2017 datë 26.3.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.972/2015 datë 28.4.2017, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar të anulohet aktvendimi nr..., datë 31.10.2014 dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe të Trustit pensional në mes të gradës 10 dhe 9, për çdo muaj duke filluar nga muaji janar i vitit 2015, e deri në rikthimin e gradës 10. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe dy aktgjykimet e lartcekura të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar .

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura në vendin e punës zyrtar për çështje pronësore- juridike në Departamentin e Punëve të Koorporatës. Me vendimin nr. ..., datë 7.3.2012, paditësit i caktohen të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 10, sipas strukturës së gradave. Më datë 31.12.2014 paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë nënshkruar kontratën e punës për kohë të pacaktuar nr. ..., datë 31.12.2014, me aplikim nga data 1.1.2015, me të cilën paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 9, sipas vendimit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të PTK –ës.

Paditësi me padi ka kërkuar të anulohet vendimi nr.015090/14 datë 31.10.2014 dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe të Trustit pensional në mes të gradës 10 dhe 9, për çdo muaj duke filluar nga muaji janar i vitit 2015, e deri në rikthimin e gradës 10.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi që nga provat e administruara nuk ka rezultuar se e paditura në raport me paditësin ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 17 e as me ndonjë dispozitë tjetër të Ligjit të Punës, me që në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është caktuar në vendin e punës për të cilën ka lidhur kontratën e punës nr. 01-6182-685/14 datë 31.12.2014, me aplikim nga data 1.1.2015, respektivisht e paditura në rastin konkret ka vepruar në harmoni me kontratën e punës të lidhur me punëmarrësin – këtu paditësin, ashtu që ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se paditësi dhe e paditura raportet e tyre i kanë rregulluar me kontratë të shkruar, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke, e cila kontratë e punës është lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen e vërtetuar faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë përmbajnë arsyet e mjaftuara për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika (n) LPK -ës, të cilat pretendime u refuzuan si të pabazuara, nga se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtojë pretendimin e paditësit të cekur në revizion se kontrata e cila i është afruar paditësit nga e paditura është nënshkruar nën kërcënim, se nëse nuk e nënshkruan të njëjtën do t'i shkëputet kontrata e punës dhe nuk është plotësuar kushti në parimet e përgjithshme të së drejtës të lidhjes së kontratës – lirisë kontraktore të palëve, por një pretendim të tillë e vlerësoi si të pabazuar, nga se në çështjen kontestimore baza e kërkesëpadisë ka qenë anulimi i aktvendimit të Bordit të Drejtorëve nr. 015090/14 datë 31.10.2014 dhe obligimi i të paditurës për pagesën e ndryshimit të pagës, më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi, e jo anulimi i kontratës së cekur, andaj gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar konform nenit 2 të LPK -ës, brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.

Pretendimi se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitën e nenit 17 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase me dispozitën e cekur është përcaktuar se i punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontratën e punës, ndërsa në rastin konkret paditësi është caktuar në vendin e punës për të cilën ka lidhur kontratën e punës nr..., me efekt nga data 1.1.2015, çka rezulton se e paditura ka vepruar në harmoni me kontratën e punës të lidhur me punëmarrësin – këtu paditësin, me pagë nga grada 9, të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi duke u pajtuar me kushtet e saj.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar nenin 55 të Ligjit të Punës, por një pretendim të tillë e vlerësoi si të pabazuar, ngase paditësi ka realizuar të ardhurat personale me gradën 9, të përcaktuara në kontratën e punës, në pajtim me ligjin dhe vendimin e Bordit të Drejtorëve të paditurës.

Për arsyet e paraqitura më lart, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.391/2018 datë 5.12.2018

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku